



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr _____ Prot

Gjirokastër më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

[31.07.2026]

Drejtuar: OE T&J Construction SHPK me NIPT **M29718101T** me adresë Elbasan Peqin Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90.

Tipi i Kontratës: mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit REF-94270-07-23-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Materiale ndërtimi Blerje materiale ndërtimi për kanalin vaditës “Zenelaj-Çepunë”**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.07.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [07.07.2026] [47]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **OE EUROBETON SHPK** me NIPT K23116602P me vlerë të ofertës së ofruar **7 619 730** (shtatë milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.
2. **OE T&J Construction SHPK** me NIPT M29718101T me vlerë të ofertës së **8 267 000** (tetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh
3. **OE TEA-D SHPK** me NIPT K32522629L me vlerë të ofertës së ofruar **8 554 400** (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë pa tvsh.

4. **OE ERVIN LUZI PF** me NIPT K71707007Q me vlerë të ofertës së ofruar **9 118 920** (nëntë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **OE EUROBETON SHPK** me NIPT K23116602P me vlerë të ofertës së ofruar **7 619 730** (shtatë milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh., nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjore, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik ka mangësi dhe nuk i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. **OE EUROBETON SHPK s'kualifikohet** për arsyet e mëposhtme:

- *Nuk plotëson pikën 2.7 të Kapacitetit teknik: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore përkatëse në preventiv, në të kundërt përbën kusht për skualifikim, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të lidhë kontratë me vlera më të larta se ato të cilat ajo disponon.”*

Çmimi total i ofertës duhet të jetë shumatorja e kodeve buxhetor V452AAB + V424AAB. Në Shtojcën 1 Formulari i Ofertës në Çmimin total të Ofertës është përcaktuar vetëm vlera e kodit V452AAB dhe jo shumatorja e të dy kodeve bashkë. Mospërcaktimi i saktë i çmimit total të ofertës përbën kusht për skualifikim.

Gjithashtu nuk jemi në kushtet e Nenit 82 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofertuar.

2. **OE TEA-D SHPK** me NIPT K32522629L me vlerë të ofertës së ofruar **8 554 400** (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë pa tvsh, nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjore, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik ka mangësi dhe nuk i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. **OE TEA-D SHPK s'kualifikohet** për arsyet e mëposhtme:

- *Nuk plotëson pikën 2.3.1: Kapaciteti teknik “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit.”*

Vlera e paraqitur e dëshmive për furnizimet e ngjashme është 1.920.000 lekë, vlerë e cila nuk plotëson vlerën 20% të kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor, e cila duhet të jetë e barabartë ose më e lartë se vlera 1.980.681,27 lekë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE T&J Construction SHPK** me NIPT **M29718101T** me adresë Elbasan Peqin Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90 se oferta e

paraqitur me vlerë **8 267 000** (tetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nertil Nebiaj